

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 31 Prot.

Vlorë më, 29. 03. 2017

V E N D I M

**Nr. 29, datë 29. 03. 2017**

Në zbatim të nenin 30 e 38, pika 1, gërma "d", dhe 82 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenet 98 e 99 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në nenin 9, pika 2, të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Senati Akademik i Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" ( në vijim KUPV);

**V E N D O S I:**

1. Të miratoj disa shtesa dhe ndryshime në pikën 1, të Vendimit nr. 26, datë 10.02.2017, të Senatit Akademik, përmbajtja e të cilës të jetë si më poshtë:
  - 1.a. Të miratoj propozimin për hapjen e njësisë bazë Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë";
  - 1.b. Të miratoj projektin për hapjen e Programit të studimit bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte". Ky program të mbart 180 kredite (60 kredite në vit) dhe të zhvillohet nga njësi bazë Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë";
  - 1.c. Programi i studimit të zhvillohet në gjuhën shqipe;
  - 1.d. Forma e studimit të jetë me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje tre vite akademike".
2. Të miratoj **Rregulloren** "Për normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të Protokollit dhe Arkivit në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë".



3. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në KUPV për vitin akademik 2017- 2018, si më poshtë:

- Kandidatë totalë: **610** (gjashtëqind e dhjetë).
- Kandidatë brenda vendit: **600** (gjashtëqind).
- Kategoritë nga trojet (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovci, Medvegja): **5** (pesë);
- Kandidatë shtetas të huaj: **5** (pesë);
- Kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar: **0** (zero);
- Kandidatë me statusin e jetimit: **2** (dy) me bursë të plotë (fëmijë të policëve të vrarë në krye të detyrës);
- Kandidatë romë dhe ballkano-egjiptianë: **2** (dy) me bursë të plotë;
- Kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh: **45** (dyzetë e pesë);
- Kandidatë që aplikojnë për program të dytë studimi: **10** (dhjetë).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Prof. Dr. Luan GJONÇAJ**



